

**PHILIP MORRIS ALBANIA sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare**

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

**Përmbledhje**

Raporti i audituesit të pavarur.....	2
Pasqyra e pozicionit financiar.....	3
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.....	6
1. Informacion i përgjithshëm.....	7
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	7
3. Manaxhimi i rrezikut financiar.....	17
4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël.....	22
5. Aktive afatgjata materiale.....	23
6. Aktivitetat më të shtyra.....	24
7. Inventari.....	24
8. Klientë dhe të tjera të arkëtueshme.....	25
9. Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente.....	25
10. Kapitali aksionar.....	26
11. Furnitorë dhe detyrime të tjera.....	26
12. Të ardhurat.....	27
13. Kosto të shitjeve.....	27
14. Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative.....	27
15. Të ardhura dhe shpenzime të tjera.....	29
16. Fitimi nga kursi i këmbimit.....	29
17. Kosto financiare neto.....	29
18. Tatimi mbi fitimin.....	29
19. Detyrime të mundshme.....	30
20. Angazhimet.....	32
21. Transaksionet me palët e lidhura.....	32
22. Ngjarje pas datës së raportimit.....	33

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionerit dhe Drejtimit të Philip Morris Albania sh.p.k

### Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Philip Morris Albania sh.p.k (“Shoqëria”) më 31 dhjetor 2017, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

#### Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017;
- pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

#### Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (“kodi i BSNEK”), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.  
PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k  
Tiranë, Shqipëri  
21 Mars 2018



  
Auditues ligjor  
Laureta Peçi Këllici

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**


(Shumat në mijë LEK, nëse nuk është e specifikuar ndryshe)

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktivet afatgjata:</b>			
Aktivet afatgjata materiale	5	110,334	143,239
Aktive tatimore i shtyrë	6	10,047	7,169
		<b>120,381</b>	<b>150,408</b>
<b>Aktivet afatshkurtra:</b>			
Inventari	7	1,086,810	1,140,005
Llogari dhe të tjera të arkëtueshme	8	15,057	230,313
Tatim fitimi i arkëtueshëm		10,974	8,772
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	9	545,181	387,907
		<b>1,658,022</b>	<b>1,766,997</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,778,403</b>	<b>1,917,405</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali aksioner	10	29,000	29,000
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit		16,538	17,893
Fitimi i pashpërndarë		149,435	72,674
		<b>194,973</b>	<b>119,567</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra:</b>			
Furnitore dhe detyrime të tjera	11	1,583,430	1,797,838
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,583,430</b>	<b>1,797,838</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,778,403</b>	<b>1,917,405</b>

Pasqyrat financiare të paraqitura në faqet 3 deri në 33 janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve më 1 Mars 2018.

  
 Administrator i Përgjithshëm  
 Radmilo Vlacić



  
 Manaxhere Finance  
 Danijela Jokic

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 33, që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK****Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhurat	12	10,561,724	9,966,552
Kosto e mallrave të shitura	13	(9,685,015)	(9,023,190)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>876,709</b>	<b>943,362</b>
Shpenzime të shitjes dhe distribucionit	14	(314,812)	(479,629)
Shpenzime administrative	14	(367,842)	(354,599)
Të ardhura të tjera	15	2,681	8,421
Shpenzime të tjera	15	(12,216)	(28,148)
Fitim nga kurset e këmbimit	16	9,819	6,109
		<b>(682,370)</b>	<b>(847,846)</b>
<b>Te ardhura të veprimtarisë së shfrytëzimit</b>		<b>194,339</b>	<b>95,516</b>
Shpenzim për interesa	17	(6,376)	(9,974)
Të ardhura nga interesat	17	1,294	1,499
<b>Kostot financiare neto</b>		<b>(5,082)</b>	<b>(8,475)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>189,257</b>	<b>87,041</b>
Shpenzime për tatim fitimin	18	(39,822)	(33,650)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>149,435</b>	<b>53,391</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>149,435</b>	<b>53,391</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqrave financiare.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK****Pasqyra e ndryshimeve në kapital***(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	Kapitali aksioner	Kapital i paguar	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>29,000</b>	<b>29,739</b>	<b>19,283</b>	<b>78,022</b>
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit	-	(11,846)	-	(11,846)
Fitimi neto i periudhës	-	-	53,391	53,391
Dividend i deklaruar / paguar	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>29,000</b>	<b>17,893</b>	<b>72,674</b>	<b>119,567</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>29,000</b>	<b>17,893</b>	<b>72,674</b>	<b>119,567</b>
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit	-	(1,355)	-	(1,355)
Fitimi neto i periudhës	-	-	149,435	149,435
Dividend i deklaruar / paguar	-	-	(72,674)	(72,674)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>29,000</b>	<b>16,538</b>	<b>149,435</b>	<b>194,973</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare**

(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>189,257</b>	<b>87,041</b>
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5	57,899	56,181
(Fitimi)/humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		6,838	(4,003)
Kosto financiare neto	17	5,082	8,475
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit		(1,355)	(11,846)
<b>Te ardhurat nga veprimtaria e shfrytëzimit përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues</b>		<b>257,721</b>	<b>135,848</b>
<b>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</b>			
Ulje / (ritje) ne inventar	7	53,195	(523,008)
Ulje/ (ritje) në llogari dhe të tjera të arkëtueshme	8	210,162	(144,839)
(Ulje) /ritje e detyrimeve ndaj furnitorëve dhe detyrimeve të tjera	11	(214,408)	583,764
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit përpara pagesës së interesit dhe tatimit mbi fitimin</b>		<b>306,670</b>	<b>51,765</b>
Tatimi mbi fitimin i paguar		(39,808)	(11,699)
Interesa neto të paguara	17	(5,082)	(8,475)
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>261,780</b>	<b>31,591</b>
<b>Veprimtaritë investuese</b>			
Blerje aktivesh afatgjata materiale	5	(33,262)	(55,623)
Të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		1,430	7,565
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë investuese</b>		<b>(31,832)</b>	<b>(48,058)</b>
<b>Veprimtaritë financuese</b>			
Pagesë e dividendit		(72,674)	-
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë financuese</b>		<b>(72,674)</b>	<b>-</b>
<b>Rritja / (pakësimi) neto e mjeteve monetare dhe të tjera ekuivalente</b>		<b>157,274</b>	<b>(16,467)</b>
<b>Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fillim të vitit</b>		<b>387,907</b>	<b>404,374</b>
<b>Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fund të vitit</b>		<b>545,181</b>	<b>387,907</b>

Pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**1. Informacion i përgjithshëm**

**a) Organizimi dhe aktivitetet**

Philip Morris Albania sh.p.k. ("Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themeluar në Tiranë, Shqipëri dhe regjistruar me vendim nr. 36432 të Gjykatës së Tiranës, datë 30 tetor 2006 në përputhje me ligjin shqiptar nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992: "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Aktivitetet kryesore të kompanisë janë: blerje, shitje, import, eksport i produkteve të duhanit, si dhe aktivitete promovuese të lidhura me produktet e duhanit. Shoqëria është e përfshirë në shitjen e këtyre markave cigaresh: Marlboro, Philip Morris, L&M, Merit. Aktivitetet e kompanisë janë të shtrira brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Aksionari i vetëm i shoqërisë është Philip Morris SA, një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Zvicrës. Shoqëria mëmë është Philip Morris International Inc.

Administratorët e shoqërisë janë: Z. Radmilo Vlacic, Drejtor i Përgjithshëm për Shqipërinë dhe Kosovën, dhe Znj. Danijela Jokic, Menaxhere Finance për Shqipërinë dhe Kosovën.

Zyra e regjistruar e shoqërisë është në Tiranë në rrugën "Murat Toptani", Qendra Eurocol, Kati 10. Shoqëria është e regjistruar si entitet i tatuësëm në qarkun Tiranë, në njësinë e tatimpaguesve të mëdhenj, me numër identifikimi K71405001S.

Shoqëria ka punësuar 38 punonjës deri më 31 dhjetor 2017 (39 punonjës më 31 dhjetor 2016).

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

**2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të Philip Morris Albania sh.p.k janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me standardet dhe interpretimet që kanë qenë në fuqi në periudhën përkatëse të pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike

**2.1.1 Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me konceptin e vijimësisë, i cili supozon se shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj për të ardhmen e parashikueshme.

**2.2 Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara**

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme janë efektive për shoqërinë nga 1 Janar 2017:

- Iniciativa për dhënien e informacioneve shpjeguese - Ndryshime në SNK 7 (lëshuar më 29 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017)
- Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara - Ndryshimet në SNK 12 (lëshuar më 19 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janar 2017)
- Ndryshime në SNRF 12 të përfshira në përmirësimet vjetore të SNRF-ve periudha 2014-2016 (lëshuar më 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017)

Asnjë nga standardet e përmendura më lart nuk ka patur një impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Standardet e reja te kontabilitetit**

Janë publikuar disa standarte dhe interpretime të reja, të cilat janë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018, të cilat Shoqëria nuk i ka zbatuar më herët.

**SNRF 9, "Instrumentet financiare: Klasifikimi dhe matja" (publikuar në korrik 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).** Pikat kryesore të standardit janë:

- Aktivet financiare duhet të klasifikohen në tre kategori matjeje: aktive të matura më pas me kosto të amortizueshme, aktive të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe ato të matura më pas me vlerën e drejte nëpërmjet fitimit dhe humbjes.
- Klasifikimi i instrumenteve të huasë bazohet tek modeli i biznesit të njësisë për menaxhimin e aktiveve financiare dhe sipas faktit nëse flukset monetare kontraktuale rrjedhin kryesisht nga pagesat e interesit dhe të kryegjësë. Nëse një instrument huaje është mbajtur për mbledhje, mund të mbartet me kosto të amortizuar nëse plotëson kushtet e pagesave të kryegjësë dhe interesave. Instrumentet e huasë që përmbushin këto kushte mbahen në një portofol ku një njësi mban dhe mbledh flukset monetare nga aktive dhe shet aktive që mund të klasifikohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Aktivet financiare që nuk përmbajnë flukse monetare që rrjedhin nga pagesat e interesit dhe kryegjësë duhet të maten me metodën e vlerës së drejtë në fitim apo humbje (për shembull, derivatet). Derivatet e përfshira nuk janë më të ndara nga aktivet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të pagesave të kryegjësë dhe interesave.
- Investimet në instrumente të kapitalit maten gjithmonë me vlerë të drejtë. Sidoqoftë, drejtimi i shoqërisë mund zgjedhë të paraqesë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti të mos mbahet për qëllime tregtimi. Nëse instrumenti i kapitalit mbahet për qëllime tregtimi, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes.
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë mbartur të pandryshuara sipas SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që njësia duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse.
- SNRF 9 prezanton një model të ri të njohjes së humbjeve së zhvlerësimit – modelin e humbjeve të pritura kreditore. Ka një qasje me tre faza e cila bazohet në ndryshimin e cilësisë kreditore të aktivit financiar që nga njohja. Në praktikë, rregullat e reja parashikojnë që njësitë duhet të njohin një humbje të drejtpërdrejtë të barabartë me humbjet e pritura kreditore për 12 muaj në njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk preken nga zhvlerësimi kreditor (apo modeli i përhershëm i humbjeve të pritura kreditore për llogaritë e arkëtueshme). Kur ka një rritje domethënëse në rrezikun kreditor, zhvlerësimi matet me modelin e përhershëm në vend të modelit 12 mujor. Ky model përfshin lehtësira operacionale për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme.
- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës janë rishikuar për një përshtatje më të mirë ndërmjet kontabilitetit dhe menaxhimit të rrezikut. Standardi i jep njësisë mundësi zgjedhje midis zbatimit të kërkesave të kontabilitetit të mbrojtës të SNRF 9 dhe zbatimit të SNK 39 sepse standardi momentalisht nuk adreson kontabilitetin mbrojtës në nivel makro.

Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

**SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).** Standardi i ri prezanton parimin bazë se të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet janë transferuar tek klientët, me koston e transaksionit. Mallrat apo shërbimet e paketuara të cilat janë të dallueshme duhet të njihen veçmas dhe uljet apo zbritjet e çmimit duhet të ndahen në elementët përkatës. Kur pagesa ndryshon për ndonjë arsye, duhet të njihet si e ardhur një shumë minimale, në rast se nuk ka rrezik të konsiderueshëm për mos-shlyerje. Shpenzimet e kryera për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfitimet e kontratës. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

## **2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.3 Standardet e reja të kontabilitetit (vazhdim)**

***Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe pjesëmarrjes së tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (lëshuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date për t'u përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit).***

Këto ndryshime adresojnë një mospërputhje të kërkesave të SNRF 10 dhe atyre të SNK 28 në lidhje me shitjen apo kontributin e aktiveve të një investitori të një pjesëmarrjeje të tij ose sipërmarrjeje të përbashkët. Pasoja kryesore e ndryshimeve është që një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes. Një fitim ose humbje e pjesshme njihet kur një transaksion përfshin aktive të cilat nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto aktive janë mbajtur nga një filial. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

***SNRF 16 "Qiratë" (publikuar në 13 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2019).*** Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, pasqyrimin dhe informacionet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë i japin të drejtën qiramarrësit të përdorë një aktiv në fillim të periudhës së qiradhënies dhe nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, i mundësojnë dhe marrje financimi. Për rrjedhojë, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirasë si qira operative apo financiare, sipas kërkesës nga SNK 17 dhe në vend të saj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qirasë. Qiramarrësit do t'i kërkohej të njohë: (a) aktive dhe detyrime për të gjitha kontratat e qirasë me një periudhë më shumë se 12 muaj, për sa kohë që aktiviteti nuk është i një vlere të ulët; dhe (b) veçmas, zhvlerësimin e aktiveve të dhëna me qira nga interesat mbi këto aktive, në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16 në thelb mbart llogaritë kontabël të qiradhënësive në SNK 17. Kështu, një qiradhënës vazhdon t'i klasifikojë qiradhëniet e tij si qira operative ose financiare dhe do t'i kontabilizojë këto dy lloje në mënyra të ndryshme. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

***Ndryshime në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 12 prill 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).*** Ndryshimet nuk ndikojnë parimet bazë të standardit, por qartësojnë mënyrën si këto parime duhet të vihen në zbatim. Ndryshimet sqarojnë si të identifikohet një detyrim performance (premtimi për të transferuar një mall apo shërbim tek një klient) në një kontratë; si të bëhet dallimi nëse një shoqëri është njësi kryesore (dhënësi i një malli apo shërbimi) apo një ndërmjetës (përgjegjës për të rregulluar dhënien e mallit apo shërbimit); dhe si të dallohet nëse të ardhurat nga dhënia e një licençe duhet të njihen në një moment të caktuar apo të shpërndahen në disa periudha. Përveç qartësimeve, ndryshimet përfshijnë dy lehtësime shtesë për një shoqëri e cila e zbaton për herë të parë standardin e ri, reduktimin e kostove dhe kompleksitetit. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

***Ndryshime në SNRF 2, Pagesa të bazuara në aksione (publikuar në 20 qershor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).*** Ndryshimet kanë për qëllim që kërkesat e kushtëzimit të palidhura me tregun të ndikojnë në matjen e transaksioneve të pagesës me aksione të shlyera në mjete monetare në të njëjtën mënyrë si shpërblimet e shlyera në kapital. Ndryshimet gjithashtu qartësojnë klasifikimin e një transaksioni shlyerjeje neto në të cilin njësi ekonomike mban një pjesë të përcaktuar të instrumenteve të kapitalit, të cilat në të kundërt do t'i jepeshin palës tjetër me të drejtën e ushtrimit (apo kushtëzimit), në këmbim të shlyerjes së detyrimit tatimor të palës tjetër, të lidhur me pagesën me bazë aksionesh. Marrëveshje të tilla do të klasifikohen tërësisht si shlyerje në kapital.

Së fundmi, ndryshimet gjithashtu qartësojnë kontabilitetin e transaksioneve për pagesa të bazuara në aksione të shlyera në mjete monetare që modifikohen për t'u shlyer në kapital, si: (a) pagesa e bazuar në aksione matet duke iu referuar vlerës së drejtë në datën e modifikimit të instrumenteve të kapitalit, dhënë si rezultat i modifikimit; (b) detyrimi çregjistrohet pas modifikimit. (c) pagesa e bazuar në aksione e shlyer në kapital njihet deri në masën kur shërbimet janë kryer deri në datën e modifikimit dhe (d) diferenca midis shumës së mbartur të detyrimit në datën e modifikimit dhe shumës së njohur në kapital në të njëjtën datë, regjistrohet menjëherë në fitim ose humbje. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

## **2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.3 Standardet e reja të kontabilitetit (vazhdim)**

**Zbatimi i SNRF 9, “Instrumentet financiarë” me SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” – Ndryshime në SNRF 4 (publikuar më 12 shtator 2016 dhe në fuqi, në varësi të metodës, për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018, për njësi të cilat zgjedhin të zbatojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm ose kur njësi zbaton në fillim SNRF 9, për njësitë të cilat zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).** Ndryshimet adresojnë problemet e lindura nga implementimi i standardit të ri mbi instrumentet financiare, SNRF 9, përpara zbatimit të standardit zëvendësues që BSNK po harton për SNRF 4. Këto probleme përfshijnë edhe paqëndrueshmëri të përkohshme në rezultatet e raportuara. Ndryshimet prezantojnë dy metoda: një metodë mbivendosje dhe një metodë shtyrjeje. Standardi i ndryshuar do u japë të gjitha shoqërive që nënshkruajnë kontrata sigurimi mundësinë që diferencat që lindin nga zbatimi i SNRF 9 para publikimit të standardit të ri për kontratat e sigurimit, t'i njohin si të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe jo në fitim apo humbje. Gjithashtu, standardi i ndryshuar, do t'u japë shoqërive në aktivitetet e të cilave mbizotërojnë ato të lidhura me sigurimet, mundësinë për të zgjedhur të jenë përkohësisht të përjashtuara nga zbatimi i SNRF 9 deri në vitin 2021. Njësitë të cilat shtojnë zbatimin e SNRF 9 do të vazhdojnë të zbatojnë standardin ekzistues për instrumentet financiarë – SNK 39. Ndryshimet në SNRF 4 shtojnë mundësi ekzistuese në standard të cilat mund të përdoren tashmë për të adresuar paqëndrueshmërinë e përkohshme. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

**Përmirësimet vjetore në SNRF-të, cikli 2014-2016 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017 për ndryshimet në SNRF 12, dhe më ose pas 1 janar 2018 për ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28.)** Përmirësimet prekin 3 standarde. Ndryshimet qartësojnë shtrirjen e kërkesave sipas SNRF 12 për paraqitjen e informacioneve shpjeguese, duke përcaktuar se kërkesat në SNRF 12 për paraqitjen e informacioneve shpjeguese, ndryshe nga ato që lidhen me informacionin e përmbledhur financiar të filialeve, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjeve, zbatohen për interesat e një njësie në njësitë e tjera, të cilat klasifikohen si të mbajtura për shitje ose për veprimtari të ndërprera, në përputhje me SNRF 5. SNRF 1 u ndryshua dhe u hoqën disa nga përjashtimet afatshkurtra nga SNRF-të në lidhje me informacionet shpjeguese për instrumentet financiare, përfitimet e punonjësve dhe njësitë investuese, pasi këto përjashtime afatshkurtra e kishin arritur qëllimin e tyre.

Ndryshimet në SNK 28 qartësojnë se një njësi ka mundësi të zgjedhë që investim pas investimi të vlerësojë investimet me vlerën e drejtë, në përputhje me SNK 28, nga një organizatë me kapital sipërmarrës, ose një fond i përbashkët, njësi besimi ose njësi të ngjashme, përfshirë fonde sigurimi të lidhura me investimet. Gjithashtu, një njësi e cila nuk është njësi investuese mund të ketë në një pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët me një njësi e cila është një njësi investuese. SNK 28 e lejon këtë njësi të ruajë matjen e vlerës së drejtë të përdorur nga njësi investuese në pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët gjatë aplikimit të metodës së kapitalit. Ndryshimet qartësojnë se kjo zgjedhje mund të bëhet gjithashtu në një bazë investim pas investimi. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

**KIRFN 22 – Transaksionet në monedhë të huaj dhe parapagimet (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).** Interpretimi adreson përcaktimin e datës së transaksionit me qëllim përcaktimin e kursit të këmbimit që do të përdoret në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimit apo të ardhurës (apo pjesë të tyre), në regjistrimin e aktivi jomonetar apo detyrimi jomonetar të lindur nga një parapagim në monedhë të huaj. Nën SNK 21, data e transaksionit për qëllime të përcaktimit të kursit të këmbimit që do të përdoret në momentin fillestar të njohjes së aktivit, shpenzimit apo të ardhurës (apo pjesë të tyre) është data në të cilën njësi njuh fillimisht aktivin apo detyrimin jomonetar që lind nga parapagimi. Nëse ka disa pagesa apo arketime në avancë, atëherë njësi duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë apo arketim në avancë. KIRFN 22 zbatohet vetëm në rrethana në të cilat një njësi njuh një aktiv ose detyrim jomonetar të lindur nga parapagimet. KIRFN 22 nuk jep udhëzime zbatimi në lidhje me përkufizimin e artikujve monetarë dhe jomonetarë. Një parapagim apo arketim në avancë, në përgjithësi sjell njohjen e një aktivi apo detyrimi jomonetar, sidoqoftë mund të sjellë dhe lindjen e një aktivi apo detyrimi monetar. Njësi mund t'u duhet të përdorin gjykimin e tyre për të përcaktuar nëse një artikull është i natyrës monetare ose jomonetare. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

## **2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.3 Standardet e reja të kontabilitetit (vazhdim)**

**Transferimet e Aktiveve Afatgjata Materiale të Investuara – Ndryshime në SNK 40 (publikuar në 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).** Ndryshimet qartësojnë kërkesat për transferimet në, ose nga, aktivet afatgjata materiale të investuara, në aktivet afatgjata materiale në proces ndërtimi. Përpara ndryshimeve, nuk kishte udhëzime specifike mbi transferimet nga ose në aktive afatgjata materiale në ndërtim e sipër në SNK 40. Ndryshimi sqaron se standardi nuk kishte qëllime për të ndaluar transferimin e një aktivi afatgjatë material në ndërtim ose zhvillim e sipër, më parë i klasifikuar si inventar, në aktiv afatgjatë material të investuar, nëse ka një ndryshim të dukshëm në përdorim. SNK 40 u ndryshua për të përforcuar parimin e transferimeve në ose nga aktivet afatgjata materiale të investuara në SNK 40, për të specifikuar se një transferim i tillë duhet të ndodhë vetëm nëse ka pasur një ndryshim në përdorimin e aktivitetit; dhe një ndryshim i tillë në përdorim do të përfshinte një vlerësim për të përcaktuar nëse aktivi afatgjatë material mund të klasifikohet si një aktiv i investuar. Një ndryshim i tillë në përdorim duhet të jetë i mbështetur me evidencë. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

### **SNRF 17 “Kontratat e sigurimit” (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).**

SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i ka dhënë njësisive pavarësi për të mbajtur kontabilitetin e kontratave të sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese. Si pasojë, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë performancën financiare të njësisive të ngjashme të sigurimit. IFRS 17 është një standard i vetëm i ngritur mbi parimet i cili kërkon njohjen dhe matjen e grupeve të kontratave të sigurimit në: (i) një vlerë aktuale të flukseve të parasë të rregulluar me normën e riskut (realizimi i flukseve monetare) e cila përfshin të gjitha informacionet në dispozicion për flukset e mjeteve monetare në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e vëzhguar të tregut, plus (nëse kjo vlerë është një detyrim) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv) (ii) një vlerë që përfaqëson fitimin e pa realizuar në grupin e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual). Investitorët do të njohin fitimin nga një grup i kontratave të sigurimit gjatë periudhës që ofrojnë mbulimin e sigurimeve, edhe pasi ato lirohen nga rreziku. Nëse një grup kontratash është ose shkakton humbje, një njësi ekonomike do të njohë menjëherë humbjen. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

### **KIRFN 23 “Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi Fitimin” (lëshuar me 1 qershor 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).**

SNK 12 specifikon mënyrën e llogaritjes së tatimit aktual dhe të shtyrë, por nuk specifikon si do të pasqyrohen efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron mënyrën e aplikimit të kriterëve të njohjes dhe të matjes të përcaktuara në SNK 12 në rastet kur ka pasiguri mbi trajtimet e tatimit mbi fitimin.

Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim të pasigurt tatimor veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera tatimore, në bazë të qasjes që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike duhet të marrë parasysh faktin se një autoritet tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të shqyrtojë dhe të ketë njohuri të plotë mbi të gjitha informacionet e lidhura me to, gjatë kryerjes së kontrolleve tatimore. Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundimin se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e fitimit ose humbjes së tatueshme, bazës së tatueshme, humbjeve tatimore të papërdorura, kreditimeve tatimore të papërdorura ose normës së tatimit, duke përdorur ose shumën më të mundshme për t'u realizuar ose vlerën e pritshme, në varësi të metodës nëpërmjet së cilës njësi ekonomike pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin e një ndryshimi në fakte dhe rrethana ose informacionet e reja që ndikojnë në gjykimet apo vlerësimet e kërkuara nga interpretimi si një ndryshim në vlerësimet kontabël. Shembuj të ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacioneve të reja që mund të rezultojnë në rishikimin e një gjykimi apo vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, kontrollet ose veprimet nga autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose skadimi i të drejtës së një autoriteti tatimor për të kontrolluar ose rikontrolluar një trajtim tatimor. Mungesa e një marrëveshjeje ose mosmarrëveshjeje nga një autoritet tatimor lidhur me një trajtim tatimor, në izolim, nuk ka të ngjarë të përbëjë një ndryshim në fakte dhe rrethana ose informata të reja që ndikon gjykimet dhe vlerësimet e kërkuara nga Interpretimi. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

## **2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.3 Standardet e reja të kontabilitetit (vazhdim)**

#### ***Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (lëshuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).***

Ndryshimet mundësojnë matjen me koston e amortizuar të huave të caktuara dhe instrumenteve të borxhit që mund të parapagohen me një shumë nën koston e amortizuar, për shembull me vlerën e drejtë ose me një shumë që përfshin një kompensim të arsyeshëm të pagueshëm ndaj huamarrësit të barabartë me vlerën aktuale të efektit të rritjes së normës së interesit të tregut gjatë jetës së mbetur të instrumentit. Përveç kësaj, teksti i shtuar në bazën për konkluzione të standardit rikonfirmim udhëzimet ekzistuese në SNRF 9 sipas të cilave modifikimet ose këmbimet e disa detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar, që nuk rezultojnë në çregjistrim, do të njihen në fitime ose humbje në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Njësitë ekonomike raportuese, në shumicën e rasteve, nuk do të jenë në gjendje të rishikojnë normën efektive të interesit për jetën e mbetur të huasë me qëllim që të shmangët ndikimi në fitim ose humbje pas një modifikimi të huasë. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

#### ***Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta. Ndryshimet në SNK 28 (lëshuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).***

Ndryshimet sqarojnë që njësitë ekonomike raportuese duhet të zbatojnë SNRF 9 për huatë afatgjata, aksionet preferenciale dhe instrumente të ngjashme që janë pjesë e një investimi neto mbi një të investuar sipas metodës së kapitalit neto para se të zvogëlojnë vlerën kontabël (neto) me një pjesë të humbjes të të investuarit që tejkalon shumën e interesit të investitorit në aksione të zakonshme. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

#### ***Përmirësimet vjetore të SNRF-ve 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (publikuar më 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).***

Ndryshimet ndikojnë katër standarte. SNRF 3 sqaroi se një blerës duhet të rimasë interesin e mëparshëm të mbajtur në një operacion të përbashkët kur siguron kontroll të biznesit. Nga ana tjetër, SNRF 11 tashmë shpjegon qartazi që investitori nuk duhet të rimasë interesin e mëparshëm të mbajtur kur siguron kontroll të përbashkët të një operacioni të përbashkët, në mënyrë të ngjashme me kërkesat ekzistuese kur një pjesëmarrje bëhet një sipërmarrje e përbashkët ose anasjelltas. SNK 12 e ndryshuar sqaron se një njësi ekonomike njihet të gjitha pasojat e tatimit mbi fitimin nga dividendët në të njëjtën mënyrë sic ka njohur transaksionet ose ngjarjet që gjeneruan fitimet për t'u shpërndarë, p.sh në fitim ose humbje ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Tashmë është e qartë që kjo kërkesë aplikohet në të gjitha rrethanat për sa kohë pagesat për instrumente financiare të klasifikuara si instrumente të kapitalit janë shpërndarje të fitimit, dhe jo vetëm në rastet kur pasojat tatimore janë rezultat i normave tatimore të ndryshme për fitime të shpërndara dhe të pashpërndara. SNK 23 i rishikuar tashmë përfshin udhëzime të qarta që huatë e marra specifikisht për financimin e një aktivi të kualifikuar përjashtohen nga grupi i kostove të përgjithshme të huamrrejeve të vlefshme për kapitalizim derisa aktivi specifik është kryesisht i përfunduar. Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë në mënyrë materiale pasqyrat financiare të shoqërisë.

### **2.4 Transaksionet në monedhë të huaj**

#### ***(a) Monedha funksionale dhe raportuese***

Zëra të përfshira në pasqyrat financiare të Shoqërisë maten duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik primar në të cilin subjekti vepron ('monedha funksionale'). Pasqyrat financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare Lek, e cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë.

#### ***(b) Transaksionet dhe balancat***

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Standardet e reja të kontabilitetit (vazhdim)**

**2.4 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

**(b) Transaksionet dhe balancat (vazhdim)**

Fitimi ose humbja neto në valutë të huaj në zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostoja e amortizuar në monedhë të huaj e përkthyer në kursin e këmbimit në fund të periudhës raportuese sikurse publikuar nga Banka e Shqipërisë. Ndryshimet në monedhë të huaj që vijnë nga këmbimi njihen në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Fitimet në valutë të huaj dhe humbjet që rezultojnë nga shlyerja e këtyre transaksioneve dhe nga këmbimi në fund të vitit të kursit të këmbimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

**2.5 Aktivet afatgjata materiale**

Aktivët afatgjata materiale janë aktivët e mbajtura për përdorim në furnizimin e shërbimeve, ose për qëllime administrative.

*Njohja dhe matja*

Aktivët afatgjata materiale maten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kosto historike përfshin të gjitha shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e mallit.

*Kostot vijuese*

Kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivit material afatgjatë kapitalizohen në vlerën mbartëse të pjesës zëvendësuese, nëse ka mundësi që shoqëria të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen nga ky pjesë dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Të gjithë kostot e tjera ditore të lidhura me aktivët afatgjata materiale njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ato ndodhin.

*Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse bazuar në metodën lineare gjatë jetës ekonomike të aktivit.

Sipas SNK 16, jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet në aspektin e përfitimeve ekonomike të pritshme të aktivit ndaj njësisë ekonomike. Prandaj, jeta e dobishme e një aktivi mund të jetë më e shkurtër se jeta ekonomike. Vlerësimi i jetës së dobishme të aktivit është çështje e gjykimit bazuar në përvojën e njësisë ekonomike me pasuri të ngjashme. Gjatë vitit 2017, kompania ka shqyrtuar jetën e dobishme të aseteve të saj dhe ka ndryshuar vlerësimet e jetës së dobishme për aktivët e kategorizuara sipas pajisjeve elektronike dhe transportit.

Jeta ekonomike e aktiveve për periudhen aktuale është si më poshtë:

	<b>01/01/2017</b>	<b>31/12/2016</b>
Mobilje dhe orendi	5 vjet	5 vjet
Mjete transporti	4 vjet	5 vjet
Pajisje elektronike	3 vjet	4 vjet

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme, dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rishikohet në çdo datë raportimi, dhe rivlerësohet nëse është e nevojshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e aktiveve janë të përcakutara nga shoqëria me vlerën e mbartur dhe janë të përshira në paqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në zërin "të ardhura të tjera".

## **2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.6 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Aktivitetet të cilat janë subjekt i amortizimit, rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera e mbartur është e pa rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi është e njohur për shumën më të cilën vlera e mbartur e aktivitetit tejkalon shumën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme e aktivitetit apo njësisë gjeneruese të parave është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Me qëllim vlerësimit të mundshëm, aktivitetet grupohen deri në njësinë më të vogël për të cilin identifikohen në mënyrë të pavarur flukse monetare (njësi gjeneruese të parasë). Aktivitetet jo financiare, përveç emrit të mirë i cili pëson zhvlerësim, janë rishikuar nëse ka mundësi për rimarrje zhvlerësimi çdo datë raportimi.

### **2.7 Aktivet financiare**

#### **2.7.1. Klasifikimi**

Shoqëria i klasifikon aktivitetet e veta financiare si hua dhe në kërkesa të arkëtueshme. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin këto aktive financiare janë blerë. Klasifikimi i aktiveve financiare përcaktohet nga drejtimi i shoqërisë në momentin e njohjes.

#### *Huatë dhe kërkesa të arkëtueshme*

Huatë dhe kërkesat e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivate me vlerë fikse ose pagesa të përcaktuara të cilat nuk janë të kuotuar në tregun aktiv. Ato janë të përfshira në aktivet afatshkurtra, përveç atyre që kanë afat maturimi më shumë se 12 muaj nga data e raportimit. Këto janë klasifikuar si aktive afatgjata. Huatë dhe kërkesat e arkëtueshme të shoqërisë janë të përcaktuara në zërin "kërkesa të arkëtueshme dhe kërkesa të tjera të arkëtueshme" dhe "mjete monetare dhe të tjera ekuivalente" në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### **2.7.2. Njohja dhe Matja**

Huatë dhe kërkesat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të cilat i përkasin drejtpërdrejt. Mbas njohjes fillestare, mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **2.7.3 Zhvlerësimi i Aktiveve Financiare**

#### *Aktivitetet e mbartura me koston e amortizimit*

Shoqëria vlerëson në fund të çdo periudhe raportimi nëse ka evidencë objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare është zhvlerësuar dhe humbja nga zhvlerësimi është e përfshirë vetëm nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (një "ngjarje humbjeje") dhe që ngjarja (ose ngjarjet) kanë një ndikim në vlerësimin e fluksit të parasë të aktivitetit financiar ose të grupit të aktiveve financiare që mund të maten me besueshmëri. Për huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, vlera e humbjes është matur si diferencë midis vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme (duke përjashtuar humbje të llogarive të arkëtueshme të cilat nuk kanë ndodhur akoma) skontuar me normën efektive të interesit të aktivitetit financiar. Vlera e mbartur e aktivitetit zvogëlohet dhe shuma e humbjes është e njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Si praktikë e dobishme, grupi mund ta masë zhvlerësimin në bazë të vlerës së drejtë duke përdorur çmimin e tregut. Në qoftë se, në një periudhë të mëpasshme, shuma e humbjeve nga zhvlerësimi ulet dhe kjo ulje vjen për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi i njohur në periudhat e mëparshme do të anulohet nëpërmjet rregullimit në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

### **2.8 Inventaret**

Inventari i mallrave tregtare (cigare) mbahet në kontabilitet me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit përcaktohet duke përdorur metodën mesatare dhe përfshin shpenzimet e kryera për blerjen dhe sjelljen e inventareve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Kostot e huamarrjes nuk përfshihen. Vlera neto e realizueshme është çmimi i pritshëm i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot deri në përfundim dhe shpenzimet e shitjes



**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.9 Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme janë shuma për te cilat klientët i detyrohen shoqërisë për mallrat e shitur gjatë ushtrimit të aktivitetit normal të biznesit. Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga zhvlerësimi.

**2.10 Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente**

Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalente përfshijnë arkën, huatë në bankë, depozitat në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me afat maturimi tre muaj ose më pak.

Çdo mjet likuid i akumuluar nga pagesat e ndryshme brenda një jave dhe i nevojshëm për të kryer pagesa të menjëhershme do të investohet në depozitat njëditore me interes ose të pakten një javore për huatë në monedhë vendase.

**2.11 Kapitali aksioner**

Aksionet e zakonshme të emetuara janë klasifikuar si kapital aksioner.

**2.12 Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime për tu paguar për mallrat ose shërbimet që janë blerë në rrjedhën e zakonshme të biznesit nga furnizuesit. Llogaritë e pagueshme janë klasifikuar si detyrime afatshkurtra nëse pagesa është detyrueshme të ekzekutohet brenda një viti ose më pak (ose nëse cikli normal i biznesit është më i gjatë).

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**2.13 Huamarrjet**

Huatë janë pasqyruar në bilanc me vlerën e drejtë minus kostot e transaksioneve. Në vazhdimësi të njohjes fillestare, detyrimet dhe huatë janë paraqitur me kosto të amortizuar dhe diferencat ndërmjet koston dhe vlerës së mbetur janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë janë klasifikuar si detyrime afatshkurtra, duke përjashtuar rastet kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë detyrimin për të paktën 12 muaj pas datës së raportimit.

Kostot e huamarrjes janë paraqitur si shpenzime në periudhën në të cilën ato kanë ndodhur.

**2.14 Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i shtyrë**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për periudhën përfshin si tatimin aktual ashtu dhe atë të shtyrë. Tatimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse. Tatim fitimi aktual (15%) llogaritet në bazë të ligjeve në fuqi në datën e raportimit, në vendin ku shoqëria gjeneron të ardhura të tatueshme. (2016: 15%) Drejtuesit e shoqërisë vlerësojnë periodikisht pozicionet e marra në deklaratat tatimore të tatim fitimit, në të cilat rregullorja tatimore e aplikueshme është subjekt interpretimi. Shoqëria llogarit provigjone kur është e përshtatshme në bazë të shumave që pritet të paguhet në organet tatimore.

Tatim fitimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pozicionit financiar, duke siguruar diferencat e përkohëshme midis vlerës kontabël të mbartur të aktiveve dhe detyrimeve në raportimin financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime të raportimit fiskal. Tatimi i shtyrë përcaktohet duke përdorur normat e interesit që pritet të aplikohen në diferencat e përkohëshme kur ato të njihen, bazuar në ligjet që janë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të jenë në dispozicion për tu përdorur kundrejt diferencave të përkohëshme. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë të raportimit dhe reduktohet deri në masën që nuk është e mundur që përfitimi që lidhet me aktivin e shtyrë tatimor do të realizohet. Aktivitet tatimore të shtyra dhe detyrimet nuk janë zbritur dhe janë klasifikuar si afatgjata.

## **PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK** **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

### **2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **2.15 Përfitimet e punonjësve**

##### *Përfitimet afatshkurtra*

Në emër të punonjësve të saj, shoqëria paguan sigurime shoqërore dhe shëndetësore të cilat janë të llogaritura mbi pagën bruto të paguar, si dhe tatim mbi të ardhurat personale mbi pagat i cili është llogaritur mbi pagën bruto. Përveç kësaj, shpenzime për vakte dhe bonuse për pushime janë paguar në përputhje me legjislacionin vendas. Këto shpenzime janë regjistruar në fitim ose humbje në periudhën në të cilën shpenzimet për paga kanë ndodhur.

##### *Ndarja e përfitimeve dhe bonuset*

Shoqëria e njeh detyrimin e saj dhe shpenzimet për të siguruar shpërblime për punonjësit (bonuse), kur ka një praktikë të kaluar që ka krijuar një detyrim konstruktiv dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i detyrimit.

##### *Pagesa të bazuara në aksione*

Philip Morris International Inc parashikon plane kompensimi në aksione për menaxhimin e të gjitha shoqërive Philip Morris Group. Këto plane janë të lidhura me aksionet e Philip Morris International Inc dhe parashikojnë kompensimin nëpërmjet pagesave të bazuara në aksione të kapitalit. Shoqëria ndërmerr plane nxitëse në të cilat punonjësit e kualifikuar për të përfituar nga skema marrin si shpërblim aksione të shtyra në kohë ku mbas një periudhe tre vjeçare (periudhë e kushtëzimit) shërbimi këto aksione mund të përfitohen. Kostoja e kompensimit për aksionet e shtyra përcaktohet mbi bazën e vlerës së drejtë të instrumentave të kapitalit të dhëna në datën e dhënies.

Vlera e drejtë e aksioneve përcaktohet në datën e dhënies. Vlera e drejtë e shërbimeve të marra nga punonjësit në këmbim të dhënies së aksioneve njihet si shpenzim. Shumat totale që duhet të shpenzohen përcaktohen duke iu referuar vlerës së drejtë të aksioneve të dhëna, duke përjashtuar ndikimin e efekteve të shërbimeve të pa lidhura me tregun dhe efektin e kushtëzimeve të performancës të përcaktuar për të përfituar aksionet (psh, përfutueshmëria, objektivat e rritjes së shitjeve, kohëzgjatja e bashkëpunimit me punonjësin përcaktuar mbi një periudhë kohore të specifikuar). Kostoja e kompensimit është e njohur gjatë periudhës së kushtëzimit, periudhë në të cilën priten të plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara. Arritjet e kushtëzimeve të shërbimit dhe të shërbimeve të pa lidhura me tregun përfshihen në ngritjen e pritshmërive rreth numrit të aksioneve që do të përfitohen nga punonjësit. Kjo pritshmëri rishikohet çdo datë raportimi dhe varianca ngarkohet në fitim/humbje, me një axhustim korrespondent në kapital.

#### **2.16 Provigjonet**

Provigjonet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) që mund të matet me besueshmëri, si pasoje e një ngjarje të shkuar dhe ka mundësi që për të shlyer detyrimin të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provigjonet përcaktohen duke aktualizuar flukset e pritshme monetare me një normë para taksave që reflekton kushtet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe riskut specifik të detyrimit.

#### **2.17 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për tu arkëtuar nga mallrat dhe shërbimet e shitura në rrjedhën e zakonshme të aktivitetit të shoqërisë. Të ardhurat janë paraqitur me vlerën e tyre neto nga TVSH, kthimet dhe zbritjet, por janë paraqitur me vlerën bruto të akcizës. Shoqëria njeh të ardhurat kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe kur plotësohen kritere të caktuara siç përshkruhet më poshtë. Shoqëria shet një gamë produktesh duhani në tregun me shumicë. Shitja e mallrave njihet kur shoqëria ka dërguar mallrat tek shitesi me shumicë (referuar më poshtë si distributori). Distributori ka liri veprimi mbi mallrat dhe çmimin e shitjes dhe nuk ka asnjë detyrim të papërbushur që mund të ndikojnë në pranimin e produkteve. Dorëzimi nuk ndodh derisa produktet janë dërguar në një vend të caktuar, rreziku i dëmtimit dhe humbjes është transferuar te distributori, dhe distributori ka pranuar mallrat sipas kontratës së shitjes, dhe mundësisë së mos-pranimit i ka kaluar afati, ose shoqëria ka një evidencë objektive që të gjitha kriteret e pranimit janë plotësuar. Shitjet janë regjistruar në bazë të çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes, neto nga çdo zbritje nga çmimi i shitjes në momentin e shitjes. Përvoja e akumuluar është përdorur për të vlerësuar dhe siguruar zbritjet.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.18 Qeratë**

Qeratë ku pjesën më të madhe të rrezikut dhe të përfitimit të pronësisë mbahen nga qeradhënësi janë klasifikuar si qera operative. Pagesat e bera për qeratë operative janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë lineare pergjatë periudhës së qerasë. Kur një qera operative përfundon përpara sesa të skadojë periudha e kontratës, çdo pagesë e kërkuar nga qeradhënësi si detyrim për prishje të kontratës do të njihet si shpenzim në periudhën që ndodh përfundimi i kontratës.

**2.19 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi i fondeve të investuara dhe të ardhurat nga këmbimet valutore. Të ardhurat nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke u bazuar mbi normën efektive të aktivitetit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë dhe humbjet nga këmbimet valutore. Shpenzimet për huatë e marra njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga këmbimet valutore janë raportuar në bazë neto.

**2.20 Krahasueshmëria**

Shifrat krahasuese janë riklasifikuar aty ku është e përshtatshme, në përputhje me ndryshimet në paraqitjen në periudhën aktuale. Këto riklasifikime, megjithatë, nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme të përmbajtjes dhe formatit të informacionit financiar siç paraqitet në pasqyrat financiare. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar vazhdimisht për të dy periudhat.

**3. Manaxhimi i rrezikut financiar**

**3.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, si: rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i kredisë, dhe rreziku i normave të interesit. Shoqëria nuk ka një program të shkruar për menaxhimin e rrezikut, por menaxhimi i pergjithshëm i rrezikut në lidhje me këto rreziqe kryhet nga departamenti i financës i shoqërisë dhe nga departamenti i administrimit të shoqërisë mëmë.

*(a) Rreziku i tregut*

*Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria blen cigare për rishitje nga furnizues të huaj dhe shlyen detyrimet e saj në euro. Të ardhurat nga shitja janë realizuar në tregun e brendshëm në Lek. Gjithashtu, shoqëria merr pjesë në transaksione ndërkombëtare dhe është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutator që rrjedh nga ekspozimi i monedhës vendase ndaj luhatjeve të monedhës së huaj, kryesisht euro dhe franga zvicerane.

Shoqëria përdor funksionin e thesarit në grup për të mbuluar rrezikun që lind nga transaksionet tregtare të shprehuara në monedhë që nuk është monedha që përdor shoqëria.

Përqendrimi kryesor i shoqërisë ndaj riskut të këmbimit valutator është drejt euro dhe franges zvicerane. Shoqëria nuk përdor instrumente derivative për tu mbrojtur nga ekspozimet kundrejt riskut të këmbimit valutator.

Ekspozimi i shoqërisë ndaj riskut të këmbimit valutator është si vijon:

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**3. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**3.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)**

*(a) Rreziku i tregut (vazhdim)*

**31 dhjetor 2017**

Në mijë Lek	EUR	USD	CHF	GBP	ALL	Totali
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	-	-	-	-	545,181	545,181
Të arkëtueshme nga klientë	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	545,181	545,181
Të pagueshme ndaj furnitorëve	446,426	456	5,510	208	64,051	516,651
Hua	-	-	-	-	-	-
	446,426	456	5,510	208	64,051	516,651
<b>Hendeku valutor më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(446,426)</b>	<b>(456)</b>	<b>(5,510)</b>	<b>(208)</b>	<b>481,130</b>	<b>28,530</b>

**31 dhjetor 2016**

Në mijë Lek	EUR	USD	CHF	ALL	Totali
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	-	-	-	387,907	387,907
Të arkëtueshme nga klientë	-	-	-	197,776	197,776
	-	-	-	585,683	585,683
Të pagueshme ndaj furnitorëve	615,415	4,289	915	79,630	700,249
Hua	-	-	-	-	-
	615,415	4,289	915	79,630	700,249
<b>Hendeku valutor më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(615,415)</b>	<b>(4,289)</b>	<b>(915)</b>	<b>506,053</b>	<b>(114,566)</b>

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat e huaja kryesore të aplikuara gjatë vitit :

ALL	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2017	2016	2017	2016
USD	119.05	124.13	111.10	128.17
EUR	134.13	137.37	132.95	135.23
CHF	120.91	126.01	113.94	126.05
GBP	153.12	168.16	149.95	157.56

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**3.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)**

*(a) Rreziku i tregut (vazhdim)*

*Analiza e ndjeshmërisë*

Duke marrë në konsideratë ndikimin e luhatjeve të kurseve të këmbimit, shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afat shkurtër në të ardhurat e saj. Në perspektivën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit të monedhave të huaja dhe normave të interesit mund të kenë ndikim në fitim.

Më 31 Dhjetor 2017, në qoftëse LEK do të kishte pësuar ngritje/ulje mesatarisht +/- 5% përkundrejt EUR, duke marrë parasysh se të gjithë faktorët e tjerë do të ishin konstantë, fitimi pas tatimit për vitin do të kishte qënë LEK 22,321 mijë më e ulët/lartë (2016: humbja për vitin do të kishte qënë LEK 30,771 mijë më e ulët/lartë), kryesisht si rezultat i humbjes/fitimit nga shkëmbimi në monedhat e huaja si Euro të dominuara nga huatë dhe llogaritë e pagueshme.

*Rreziku i normës së interesit mbi flukset monetare dhe vlerën e drejtë*

Rreziku i normës së interesit të flukseve monetare është rreziku që flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit është rreziku se vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Shoqëria ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut si ndaj vlerës së drejtë ashtu dhe ndaj rrezikut të rrjedhës së parasë. Marzhet e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të ulë humbjet në rast ndryshimesh të papritura.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e vlerës së drejtë të shoqërisë ndaj riskut të normës së interesit. Ajo përfshin instrumente financiare të kompanisë me vlerat e mbetura të kategorizuara nga rivlerësimi më i hershëm.

në mijë Lek	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Pa interes	Totali
<b>31 Dhjetor 2017</b>				
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	545,181	-	-	545,181
Të arkëtueshme nga klientë	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>545,181</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>545,181</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Huatë nga Banka / Palë të lidhura	-	-	-	-
Të pagueshme ndaj furnitorëve	-	-	516,651	516,651
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>516,651</b>	<b>516,651</b>
<b>Hendeku nga rivlerësimi i interesit</b>	<b>545,181</b>	<b>-</b>	<b>(516,651)</b>	<b>28,530</b>

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**3.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)**

*(a) Rreziku i tregut (vazhdim)*

në mijë Lek	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	Pa interes	Totali
<b>31 Dhjetor 2016</b>				
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	387,907	-	-	387,907
Të arkëtueshme nga klientë	-	-	197,776	197,776
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>387,907</b>	<b>-</b>	<b>197,776</b>	<b>585,683</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Huatë nga Banka / Palë të lidhura	-	-	-	-
Të pagueshme ndaj furnitorëve	-	-	700,249	700,249
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>700,249</b>	<b>700,249</b>
<b>Hendeku nga rivlersimi i interesit</b>	<b>387,907</b>	<b>-</b>	<b>(502,473)</b>	<b>(114,566)</b>

Shoqëria nuk ka asnjë aktiv ose detyrim me vlerë të drejtë që mbart normë fikse interesi dhe si rrjedhojë nuk njuh asnjë humbje ose fitim, gjithashtu shoqëria nuk përdor asnjë derivat. Si rrjedhojë një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojë në fitimi ose humbje.

*(b) Rreziku i kredisë*

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë, nëse një klient ose pala e lidhur nga një instrument financiar nuk arrijnë të përmbushin detyrimet kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë nga klientët. Rreziku i kredisë vjen edhe nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre si dhe depozitat në banka, ekspozimet e kreditit ndaj klientit, duke përfshirë arkëtimet dhe transaksionet e kryera të pashlyera në rastin kur klienti i tij kryesor nuk ka aftësinë për të përmbushur detyrimet e tij.

Shoqëria ka vetëm një klient i cili ka si afat pagese +6 ditë , prandaj shoqëria nuk ka përqëndrim të konsiderueshëm të rrezikut të kredisë.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Aktivët Financiare</b>		
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	545,181	387,907
Të arkëtueshme nga klientë	-	197,776
<b>Totali</b>	<b>545,181</b>	<b>585,683</b>

*(c) Rreziku i likuiditetit*

Menaxhimi i kujdesshëm i rrezikut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parave të disponueshme në mënyrë që të përmbushen të gjitha detyrimet financiare në kohë. Departamenti i financave rregullisht monitoron burimet e disponueshme të parave dhe ka një fokus të fortë në rrjedhën e parave duke përditësuar parashikimet ditore dhe mujore.

Tabela e mëposhtme analizon detyrimet financiare të shoqërisë në grupime sipas maturimit përkatës të bazuar në periudhën e mbetur në pasqyrën e pozicionit financiar deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat e paraqitura në tabelë janë flukse monetare të parasë të pa skontuara. Shumat që janë për tu paguar brenda 12 muajve janë të barabarta me vlerën e tyre historike sepse impakti i skontimit nuk është material.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**3.1 Faktorët e rrezikut financiar (vazhdim)**

*(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)*

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	Totali
<b>31 Dhjetor 2017</b>			
<i>Aktive financiare</i>			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	545,181	-	545,181
Të arkëtueshme nga klientë	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>545,181</b>	<b>-</b>	<b>545,181</b>
<i>Detyrime financiare</i>			
Hua nga palë të lidhura/banka	-	-	-
Të pagueshme ndaj furnitorëve	258,490	258,161	516,651
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>258,490</b>	<b>258,161</b>	<b>516,651</b>
<b>Hendeku i parregulluar i aktiveve dhe detyrimeve</b>	<b>286,691</b>	<b>(258,161)</b>	<b>28,530</b>

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	Totali
<b>31 Dhjetor 2016</b>			
<i>Aktive financiare</i>			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	387,907	-	387,907
Të arkëtueshme nga klientë	197,776	-	197,776
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>585,683</b>	<b>-</b>	<b>585,683</b>
<i>Detyrime financiare</i>			
Hua nga palë të lidhura/banka	-	-	-
Të pagueshme ndaj furnitorëve	504,457	195,792	700,249
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>504,457</b>	<b>195,792</b>	<b>700,249</b>
<b>Hendeku i parregulluar i aktiveve dhe detyrimeve</b>	<b>81,226</b>	<b>(195,792)</b>	<b>(114,566)</b>

Edhe pse hendeku i likuiditetit është negativ, shumica e llogarive të pagueshme me maturitet 90 ditë lidhen me Philip Morris International Tolling SA e cila është një palë e lidhur.

Një linjë kredie me vlerë prej 100 milionë lekë është në dispozicion me Intesa San Paolo Bank Albania me normë të veçantë të interesit në indeksin e bonove të thesarit 6-mujore plus 100 bps, e cila nuk është përdorur gjatë vitit 2017. Shoqëria rinovon kredinë çdo vit, marrëveshja aktuale skadon në 30 shtator 2018.

Bazuar në Ligjin e akcizës nr. 61/2012 që ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2012, e cila lejon pagesën e shtyrë të akcizës me kusht depozitimin e një garancie bankare të vlefshme pranë autoriteteve doganore, që nga 24 shtator 2012 një marrëveshje është nënshkruar mes Philip Morris Albania Sh.p.k. dhe Intesa SanPaolo Bank Albania. Shuma e marrëveshjes është ALL 1,200,000,000 (një miliard e dy njëqind mijë lekë) me një komision prej 0.5% p.a. Kjo marrëveshje është shtyrë deri në shtator 2018.

Më 11 korrik 2015, Intesa SanPaolo Bank Albania ka lëshuar garanci në shumën 78.000.000 lekë (shtatëdhjetë e tetë milion Lek) kundrejt autoriteteve tatimore, dhe mbulon detyrimet dhe interesat e vendosura nga organet tatimore për shkak të një inspektim tatimor ndjekur nga njoftimi për detyrimet nr. 2442/13 datë 16 qershor 2014 dhe 2442/16 datë 26 qershor 2014. Kjo garanci është shtyrë deri në shtator 2018.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

---

**3. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**3.2 Menaxhimi i kapitalit**

Objektivat e kompanisë gjatë menaxhimit të kapitalit janë:

Të ruajnë aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi, në mënyrë që të sigurojë kthimin e kapitalit për pronarët dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit dhe për të ulur koston e kapitalit.

Totali i kapitalit është llogaritur si "kapital" siç tregohet në bilanc plus borxhin neto.

Me qëllim mbajtjen dhe korigjimin e strukture së kapitalit shoqëria mund të ndryshojë shumën e fitimit që i shpërndahet aksionereve, shpërndarjen e kapitalit tek aksionerët, shtimin e kapitalit ose shitjen e aktiveve për të ulur borxhet.

Shoqëria nuk ka hua afatgjata.

Shoqëria nuk është institucion financiar dhe si rrjedhojë nuk është e detyruar të jetë në pajtueshmëri me asnjë kërkesë mbi kapitalin të vendosura nga rregullatorët.

**4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël**

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas përcaktimit, rralëherë të barabarta me rezultatet aktuale. Vlerësime dhe supozime të cilat kanë ndikimin më të madh në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare janë përfshirë në notën 19 "Detyrime të mundshme"

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht dhe janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet se janë të arsyeshme në rrethanat.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit do të rezultojnë, sipas përcaktimit, rralëherë të barabarta me rezultatet aktuale. Vlerësime dhe supozime të cilat mund të kenë një ndikim në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar më poshtë.



**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**5. Aktive afatgjata materiale**

Aktivitet afatgjata materiale janë analizuar si më poshtë:

Kosto	Mobilje dhe orëndi	Mjete transporti	Pajisje elektronike	Përmirësime në objektet me qira	Punilme në proces	Totali
Më 1 janar 2016	166,182	95,354	23,316	8,411	24,123	317,386
Riklasifikime	23,505	-	618	-	(24,123)	-
Shtesat	16,796	19,727	12,465	-	6,635	55,623
Pakësimet	(23,273)	(47,069)	(5,090)	-	-	(75,432)
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>183,210</b>	<b>68,012</b>	<b>31,309</b>	<b>8,411</b>	<b>6,635</b>	<b>297,577</b>
Më 1 janar 2017	183,210	68,012	31,309	8,411	6,635	297,577
Shtesat	19,930	-	12,785	-	547	33,262
Pakësimet	(4,713)	(2,394)	(4,930)	-	(6,651)	(18,688)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>198,427</b>	<b>65,618</b>	<b>39,164</b>	<b>8,411</b>	<b>531</b>	<b>312,151</b>
Zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2016	(99,203)	(55,042)	(11,998)	(3,785)	-	(170,028)
Shpenzimi i vitit	(28,810)	(19,493)	(6,195)	(1,682)	-	(56,180)
Pakësimet	22,097	45,866	3,907	-	-	71,870
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(105,916)</b>	<b>(28,669)</b>	<b>(14,286)</b>	<b>(5,467)</b>	<b>-</b>	<b>(154,338)</b>
Më 1 janar 2017	(105,916)	(28,669)	(14,286)	(5,467)	-	(154,338)
Shpenzimi i vitit	(27,055)	(18,256)	(10,906)	(1,682)	-	(57,899)
Pakësimet	3,478	2,394	4,548	-	-	10,420
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(129,493)</b>	<b>(44,531)</b>	<b>(20,644)</b>	<b>(7,149)</b>	<b>-</b>	<b>(201,817)</b>
<b>Vlera kontabël Neto</b>						
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>77,294</b>	<b>39,343</b>	<b>17,023</b>	<b>2,944</b>	<b>6,635</b>	<b>143,239</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>68,934</b>	<b>21,087</b>	<b>18,520</b>	<b>1,262</b>	<b>531</b>	<b>110,334</b>

Sipas SNK 16, jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet në aspektin e përfitimeve ekonomike të pritshme të aktivit ndaj njësive ekonomike. Për këtë arsye, jeta e dobishme e një aktivi mund të jetë më e shkurtër se jeta ekonomike. Vlerësimi i jetës së dobishme të aktivit është çështje gjyqimi bazuar në përvojën e njësive ekonomike me pasuri të ngjashme. Ka pasur një ndryshim në jetën e dobishme të aktiveve të kategorizuara sipas pajisjeve elektronike dhe transportit gjatë vitit 2017. Ndikimi në pasqyrën e të ardhurave për shkak të këtij ndryshimi është 8,130,101 Lek. Ju lutemi referojuuni shënimit 2.5 për detaje të mëtejshme.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**6. Aktivet tatimore të shtyra**

Lëvizja në aktivet tatimore të shtyra analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Në fillim të vitit	7,169	7,254
Shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave	2,878	(85)
<b>Totali:</b>	<b>10,047</b>	<b>7,169</b>

Norma tatimore e aplikueshme për qëllimet e llogaritjes së tatimeve të shtyra është 15% (2016: 15%).

Të gjitha lëvizjet në tatimin e shtyrë janë njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

	Amortizim i përsheptuar	Zhvlerësim i inventarit	Pagesa me bazë aksione	Pensione	Shpenzime të përlogaritura për punonjësit e huaj	Totali
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>6,063</b>	<b>1,191</b>	-	-	-	<b>7,254</b>
Ngarkuar / (kredituar) në fitim ose humbje	(976)	-	-	891	-	(85)
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>5,087</b>	<b>1,191</b>	-	<b>891</b>	-	<b>7,169</b>
Ngarkuar / (kredituar) në fitim ose humbje	(1,511)	(1,085)	2,481	279	2,714	2,878
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>3,576</b>	<b>106</b>	<b>2,481</b>	<b>1,170</b>	<b>2,714</b>	<b>10,047</b>

**7. Inventari**

Inventari përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mallrat e përfunduara-cigaret	1,116,617	1,161,515
Zhvlerësimi i inventarit	(29,807)	(21,510)
<b>Totali</b>	<b>1,086,810</b>	<b>1,140,005</b>

Lëvizja në zhvlerësimin e inventarit gjatë fundit të vitit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Zhvlerësimi në fillim të vitit	21,510	21,510
Kosto e periudhës	29,103	-
Anullime	(20,806)	-
<b>Totali</b>	<b>29,807</b>	<b>21,510</b>

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**8. Klientë dhe të tjera të arkëtueshme**

Klientë dhe të tjera të arkëtueshme përshkruhen në tabelën në vijim:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme nga klientë	-	197,776
Shpenzime të shtyra	684	1,737
Të tjera të arkëtueshme	14,373	30,800
<b>Totali</b>	<b>15,057</b>	<b>230,313</b>

**Të tjera të arkëtueshme**

Llogari e tjera të arkëtueshme përshkruhen në tabelën në vijim:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Parapagime për furnitorët	442	365
Taksë akcize e arkëtueshme	11,271	24,585
Parapagime të tjera	2,660	5,850
<b>Totali</b>	<b>14,373</b>	<b>30,800</b>

Vlera e akcizës për tu rimbursuar i përket pjesës së mallrave që janë për tu shkatërruar, ribursimi për të cilat do të bëhet nga autoritetet tatimore. Shoqëria është e bindur se do të rimbursohet për gjithë vlerën e akcizës meqënëse ajo lidhet me mallrat për tu shkatërruar për të cilat është ndjekur procedura sipas ligjeve në fuqi. Ndryshimet në vlerat e akcizës për tu rimbursuar janë të lidhura me taksën e akcizës mbi pullat fiskale, të cilat janë rimbursuar gjatë vitit.

Vlera kontabël e klientëve dhe llogarive të tjera të arkëtueshme është në LEK.

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë, këmbimit valutor dhe humbjes nga zhvlerësime për llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera janë paraqitur në shënimin shpjegues 3.

**9. Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente**

Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalentet janë analizuar si mëposhtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Gjendja në bankë</b>		
Në monedhen vendase	545,181	387,907
	<b>545,181</b>	<b>387,907</b>
Mjete monetare në tranzit	-	-
<b>Totali</b>	<b>545,181</b>	<b>387,907</b>

Mjetet monetare në bankë janë mbajtur me Intesa Sanpaolo Bank. Filialet e bankave shqiptare nuk janë të vlerësuara, megjithatë Intesa Sanpaolo Group ka vlerësimin AA-,

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë, këmbimit valutor dhe humbjes nga zhvlerësime për llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera janë paraqitur në shënimin shpjegues 3.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**10. Kapitali aksionar**

	Numri i aksioneve të zakonshme	Vlera në LEK
Më 31 dhjetor 2016	1,000	29,000
Më 31 dhjetor 2017	1,000	29,000

Kapitali aksionar i shoqërisë zotërohet plotësisht 100% nga Philip Morris SA. Shoqëria mëmë është Philip Morris International Inc.

***Pagesat e bazuara në aksione.***

Kompania operon me një numër të planeve të kompensimit të bazuara në aksione të rregulluara me kapital neto, sipas të cilave njësia ekonomike merr shërbime nga punonjësit si shpërblim për aksionet në kapitalin e kompanisë. Punonjësit e kualifikuar marrin kompensime afatgjata të kapitalit që u japin aksione të PMI pas një periudhe shërbimi tre vjeçare.

**11. Furnitorë dhe detyrime të tjera**

Furnitorë dhe detyrime të tjera janë analizuar si mëposhtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë	82,760	95,724
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura (shënimi 21)	433,891	604,525
Detyrime të tjera	214,787	229,123
Taksat dhe detyrimet	4,060	3,111
Detyrimi tatimor i akcizës dhe TVSH	847,932	865,355
<b>Totali</b>	<b>1,583,430</b>	<b>1,797,838</b>

Detyrimet ndaj palëve të lidhura përbëhen kryesisht nga detyrimet ndaj Philip Morris SA për blerjen e cigareve nga fabrikat e prodhimit bazuar në Poloni dhe Rumani, të cilat nuk janë paguar në fund të vitit. Termat e pagesës janë brenda 90 ditëve.

Furnitorët janë detajuar si vendas dhe të huaj si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë vendas	76,216	79,593
Furnitorë të huaj	6,544	16,131
<b>Totali</b>	<b>82,760</b>	<b>95,724</b>

Llogaritë e pagueshme për palët e lidhura janë paraqitur në shënimin shpjegues 21. Ekspozimi i shoqërisë për likuiditetet dhe rrezikun nga këmbimi valutor që dalin nga llogaritë e pagueshme janë paraqitur në shënimin shpjegues 3.

***Detyrime të tjera***

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të përlllogaritura për shitje dhe marketing	59,917	79,946
Shpenzime administrative të përlllogaritura	49,678	47,823
Të tjera shpenzime të përlllogaritura – audit tatimor	105,192	101,354
<b>Totali</b>	<b>214,787</b>	<b>229,123</b>

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**11. Furnitorë dhe detyrime të tjera (vazhdim)**

*Detyrime të tjera (vazhdim)*

Shpenzimet e përlogaritura të marketingut dhe të shitjeve janë gjerësisht të lidhura me shitjen e produktit dhe bazohen në kontrata të rëna dakort. Shpenzimet administrative të përlogaritura përfshijnë shpenzime të përlogaritura për energji, ujë, telekomunikacion, si dhe parashikime për shpenzime të tjera si kosto trainimesh, shpenzime auditimi, shërbime ligjore dhe bonuse për punonjësit. Të tjera shpenzime përfshijnë detyrimet për autoritetet tatimore nga inpektimet tatimore të kryera më 2014 dhe 2016, si dhe Çështjen Tatimore 3 e cila ka një garanci bankare, gjë që i ka sjellë Shoqërisë penaltite shtesë interesi. Për të parë detajet lidhur me këto shpenzime referojuni shënimit shpjegues 19.

**12. Të ardhurat**

Te ardhurat të paraqitura në pasqyrat e të ardhurave janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitjet e cigareve	10,561,724	9,966,552
<b>Totali</b>	<b>10,561,724</b>	<b>9,966,552</b>

Shitjet janë paraqitur në vlerën neto duke zbritur kompensimin tregtar dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, por bruto për sa i përket akcizës

**13. Kosto të shitjeve**

Shpenzimet e mallrave të shitura, të paraqitura në pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kosto e mallrave të shitur	9,685,015	9,023,190
<b>Totali</b>	<b>9,685,015</b>	<b>9,023,190</b>

Kostoja e mallrave të shitura përfshin koston e mallrave (koston e blerjes), koston e taksës së akcizës, dhe kosto të tjera të lidhura me blerjet.

**14. Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative**

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të shitjes dhe distribucionit	314,812	479,629
Shpenzime administrative	367,842	354,599
<b>Totali</b>	<b>682,654</b>	<b>834,228</b>

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**14. Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative (vazhdim)**

Shpenzime të shitjes, distribucionit dhe administrative janë të analizuara si më poshtë.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime akomodimi	9,638	10,768
Shpenzime për komunikim	191,740	272,108
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	57,899	56,181
Shpenzime/kompesime brenda grupit	63,266	65,573
Kompensimi per menaxhimin kryesor	53,194	113,589
Kërkim e studim tregu	29,831	45,032
Qera për zyra dhe magazinë	15,955	19,783
Mirëmbajtje dhe riparime PPOSM	3,119	5,303
Kosto personeli	101,608	91,850
Telefon/celular/shpenzime Interneti	4,586	3,798
Shpenzime transporti	8,337	8,348
Shpenzime për automjetet e shoqërisë	27,446	30,455
Shpenzime ligjore	8,457	11,593
Të tjera	107,578	99,847
<b>Totali</b>	<b>682,654</b>	<b>834,228</b>

Shpenzimet e personelit të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Rrogat dhe përfitime të tjera të punonjësve	92,544	83,408
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	9,064	8,442
<b>Totali</b>	<b>101,608</b>	<b>91,850</b>

Shpenzime te tjera jane analizuar si me poshte:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime trajnimi për punonjësit	8,735	18,176
Shpenzime per punonjesit e huaj	38,567	22,876
Shenzime udhëtimi	7,186	12,120
Shërbime konsulence	23,263	22,966
Ujë, drita, pastrim	3,846	6,388
Shpenzime sigurimi	4,538	3,583
Mostra për analiza cigaresh	1,596	1,548
Anëtarësime	991	932
Shpenzime për mbledhje e konferenca	998	1,737
Të tjera	17,858	9,521
<b>Totali</b>	<b>107,578</b>	<b>99,847</b>

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**15. Të ardhura dhe shpenzime të tjera**

Të ardhura të tjera të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tarifat e shërbimit - palët e lidhura	-	-
Të ardhura të tjera	2,681	8,421
<b>Totali</b>	<b>2,681</b>	<b>8,421</b>

Të ardhura të tjera pasqyrojnë kryesisht të ardhura nga shitja e pajisjeve elektronike dhe mjeteve të transportit.

Shpenzime të tjera të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime tatimore	4,744	24,252
Të tjera	7,472	3,896
<b>Totali</b>	<b>12,216</b>	<b>28,148</b>

**16. Fitimi nga kursi i këmbimit**

Diferencat nga kursi i këmbimit të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Humbjet nga transaksionet e këmbimit valutor	(16,672)	(13,540)
Fitimet nga transaksionet e këmbimit valutor	26,491	19,649
<b>Totali</b>	<b>9,819</b>	<b>6,109</b>

**17. Kosto financiare neto**

Kostot financiare-neto, të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhurat nga interesi në llogari rrjedhëse	1,294	1,499
Shpenzime për interesa mbi huatë bankare	(6,376)	(9,974)
<b>Totali</b>	<b>(5,082)</b>	<b>(8,475)</b>

**18. Tatimi mbi fitimin**

Detyrimi tatimor për vitin është paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim fitimi aktual	42,700	33,565
Tatimi i shtyrë (shënimi 6)	(2,878)	85
<b>Total</b>	<b>39,822</b>	<b>33,650</b>

Norma e tatimit mbi të ardhurat e zbatueshme në të ardhurat e kompanisë në 2017 është 15% (2016: 15%).

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**18. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Shpenzimi për vitin, mund të rakordohet me fitimin e paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë:

		31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
Fitimi para tatimit		189,257		87,041	
Tatim fitimi i përlogaritur në 15%	15.00%	28,389	15.00%	13,056	
Shpenzime të pazbritshme	6.06%	11,466	20.37%	17,732	
Rivleresim i tatim fitimit të vitit të shkuar	0.00%	-	0.00%	-	
Diferenca të përkohshme	1.5%	2,845	3.19%	2,777	
<b>Shpenzimet e tatimit mbi fitimin</b>	<b>22.56%</b>	<b>42,700</b>	<b>38.56%</b>	<b>33,565</b>	

Aktivet tatimore të shtyra janë klasifikuar për shkak të diferencave të përkohshme që lindin midis vlerës së tatueshme dhe vlerës kontabël të aktiveve të Shoqërisë. Detaje të llogaritjes së aktiveve tatimore të shtyra janë paraqitur në shënimin shpjegues 6.

**19 Detyrime të mundshme**

*(a) Tatimet*

Shoqëria ka katër çështje me Departamentin Rajonal të Tatimeve dhe Departamentin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

**Çështja nr. 1.** Kjo çështje është ngritur nga Philip Morris Shqipëri ( "PMA") lidhur me njoftimin e vlerësimit tatimor no.29142 / 7 të datës 21 shkurt 2011. Padia e pare është ngritur më 18 gusht 2011. Mbas një vendimi të gjykatës së lartë ku të gjitha çështjet administrative përfshirë edhe ato në pritje pranë gjykatës rajonal Tiranë duhet të transfroheshin pranë gjykatës administrative të shkallës së pare, çështja rifilloi më 25 prill 2014. Më 9 korrik 2014 gjykata administrative e shkallës së pare vendosi:

- i) Të pranojë pretendimet e PMA në lidhje me detyrimin për tatimin mbi vlerën e shtuar në vlerën prej 650,000 Lek (afërsisht 6,500 Usd)
- ii) Të refuzojë të gjitha pretendimet e tjera lidhur me tatim fitimin për vitet 2007, 2008 dhe 2009 si dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore për vitet 2008 dhe 2009.

Shoqëria apeloj vendimin pranë gjykatës administrative të apelit më 24 korrik 2014. Njëkohësisht Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve apeloj pjesë të vendimit në lidhje me detyrimin e TVSH-së. Më 26 tetor 2016 Gjykata Administrative e Apelit e qarkut Tiranë me vendim numër 3503 refuzoi kërkesën e ngritur nga shoqëria dhe pranoi kërkesën e drejtorisë rajonale tatimore. Më 15 dhjetor 2016 PMA ngriti një rekursë pranë gjykatës së lartë. Çështja pritet të gjykohet në vitin 2020. Shoqëria i ka paguar të gjitha penalitetet e lidhura me këtë çështje pjesërisht në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe pjesërisht duke zvogëluar balancën e parapaguar të CIT nga vitet paraardhëse.

**Case 2 A:** Kjo çështje gjyqësore e ngritur nga PMA është e ndërlidhur me Njoftimin për Vlerësimin Tatimor nr.8679 / 4 të datës 19.08.2013 të lëshuar nga Zyra Rajonale e Tatimeve Tatimore e Tatimeve të Tiranës dhe Vendimi i TAD Nr.16700 / 2, datë 18.12.2013. Pas shfrytëzimit të ankesës administrative të taksave, PMA ngriti padi në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative të Tiranës dhe gjatë procesit gjyqësor PMA paraqiti deklaratën relevante të kërkesave. Më 24 nëntor 2014, Gjykata nxori vendimin nr.6760 për refuzimin e padisë së PMA lidhur me detyrimet e TVSH-së dhe CIT-së të ngarkuara në lidhje me dështimin e PMA për të lëshuar faturë tatimore në rastin e rritjes së RTP për mallrat që qëndrojnë në pronësinë e distributorit dhe në lidhje me mallrat shitur nën koston. Ankesa gjyqësore është parashtruar më 3 dhjetor 2014 dhe kërkesa e plotë ankimore është parashtruar më 24 dhjetor 2014. Me aktgjykimin nr. 3804 dt. 10.11.2016, Gjykata Administrative e Apelit hodhi poshtë kërkesën për ankesë të PMA dhe më 06.01.2017, PMA paraqiti rekursin e duhur në Gjykatën Supreme (Seksioni Administrativ). Rekursi pritet të rishikohet në vitin 2020. Kompania ka paguar pjesërisht ndëshkimet lidhur me këtë rast. Pjesa tjetër e gjobave është anuluar në përputhje me ligjin nr. 39/2014, datë 17.04.2014 "Për amnistinë e gjobave administrative në formë gjobash".



**19. Detyrime të mundshme (vazhdim)**

**Case 2 B:** Kjo çështje gjyqësore e ngritur nga Zyra VIP / Padiësi lidhet me Njoftimin për Vlerësimin Tatimor nr.8679 / 4 të datës 19.08.2013 të lëshuar nga Zyra Rajonale e Tatimeve Tatimore e Tatimeve Tiranë dhe Vendimi TAD nr. 16700/2 të datës 18.12.2013. Në këtë proces gjyqësor kur PMA është thirrur të marrë pjesë në cilësinë e palës së tretë në proces gjyqësor, i pandehuri është Drejtoria e Apelit të Tatimeve ('TAD'). Kërkesa lidhet me TVSH-në e ngarkuar nga zyra VIP për mos lëshim fature tatimore nga PMA dhe për detyrimin e TVSH-së gjatë vitit 2010 dhe 2011 për mallrat që i nënshtrohen tërheqjes nga tregu për tu asgjësuar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me aktgjykimin e saj përkatës e hodhi poshtë padinë e Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj (Zyra VIP). Zyra VIP e apeluar pritet të gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit në shkurt të vitit 2020. Kompania nuk e ka privigjionuar këtë rast pasi ka fituar procedurat e para të Gjykatës.

**Case 3:** Kjo çështje gjyqësore e ngritur nga PMA është e ndërlidhur me Njoftimin për Vlerësimin Tatimor nr. 2442/13 të datës 16.06.2014 dhe Njoftimit për Vlerësimin Tatimor nr.2422 / 16 të datës 25.06.2014 të lëshuar nga Zyra Rajonale e Taksave të Tatimpaguesve të Tiranës dhe Vendimi TAD Nr.19805 / 2 të datës 15.10.2014. Pasi e kishte shteruar ankesën administrative kur Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin e saj nr. 19805 pjesërisht pranoi ankesën e PMA lidhur me zbritjen e TVSH-së për tarifën e dhomave të konferencave, ujit të pijshëm dhe disa furnizimeve për pastrim në shumën prej 420,978 Lek (rreth 4000 USD) dhe refuzoi kërkesat e tjera në lidhje me TVSH dhe CIT për vitin 2009 dhe 2013, më 14.11.2014 PMA paraqiti një padi në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative në Tiranë dhe gjatë procesit gjyqësor PMA paraqiti deklaratën përkatëse të kërkesave që mbrojnë pozitën e PMA që ky i fundit të mos paguajë TVSH shtesë ose CIT për rritjen e RTP për mallrat që qëndrojnë në pronësi dhe posedim të Distributorit, si dhe mbrojtjen e pozicioneve të PMA lidhur me shpenzimet / kostot që duhet t'i jepen kostos së produktit. Padija e PMA u refuzua nga Gjykata e Shkallës së Parë Administrative të Tiranës me vendimin nr. 1821, datë 7.04.2015 dhe kërkesa e ankesës gjyqësore përkatëse i është dorëzuar rregullisht Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë më 21 prill 2012. Ankesa u refuzua më 25 maj 2017. Më 1 korrik 2017, kompania paraqiti rekursin përkatës gjyqësor në Gjykatën Supreme. Kompania po pret që gjykata të caktojë datën e gjykimin, e cila pritet të planifikohet në vitin 2020. Vini re se në lidhje me zbritjen e TVSH-së për tarifën e dhomave të konferencave, ujit të pijshëm dhe disa furnizimeve për pastrim, zyra VIP nuk e ka ndjekur rastin. Shoqëria e ka privigjionuar pjesërisht këtë rast.

**Case 4 A:** Kjo çështje gjyqësore është ngritur nga PMA dhe lidhet me Njoftimin për Vlerësimin Tatimor nr.02 / 4 të datës 11.04.2016 të lëshuar nga Zyra Rajonale e Tatimeve Tatimore e Tatimeve të Tiranës dhe Vendimi i TAD Nr.14921 / 3 i datës 8.08.2016. Pasi e kishte shteruar ankesën administrative (ku Drejtoria e Ankesave Tatimore me vendimin e saj nr.14921 / 3 të datës 8.08.2016 pjesërisht pranoi ankesën e PMA lidhur me detyrimet e CIT të ngarkuara nga VIP Office / Pandehuri për shkak të shpenzimeve të cilat nuk ishin njohur si të zbritshme për shkak të dështimit PMA të paguajë PSH ose të shterojë procedurën e aplikimit të DTT-së dhe refuzoi CIT e tjera lidhur me kërkesat për 2013 dhe 2014) më 7.09.2016 PMA ka paraqitur një padi në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative të Tiranës dhe gjatë procesit gjyqësor PMA ka dorëzuar deklaratën relevante me të cilën pretendon të kundërshtojë detyrimet tatimore që lidhen me CIT të ngarkuara për PMA për vitet fiskale 2013 dhe 2014 të tilla që kanë të bëjnë me dështimin e PMA të paguajë dhe deklarojë CIT shtesë për rritjen e RTP dhe për dështimin e PMA të japë shpenzime të zbritshme të cilat nuk njiheshin si të tilla për dështimin e PMA që të dokumentojë me të drejtë shpenzimet lidhur me udhëtimin me taksë dhe trajnimin e personelit. Me Aktgjykimin nr.5851 (07122) të datës 21.11. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës refuzoi padinë e PMA dhe prandaj më 5.12.2016, PMA paraqiti një kërkesë për ankesë në Gjykatën e Apelit Tiranë për të kundërshtuar këtë aktgjykim. Rasti pritet të gjykohet në vitin 2019. Shoqëria ka paguar shumën e plota që dalin nga ky rast gjatë viteve të mëparshme.

**Case 4 B:** Ky proces gjyqësor u ngrit nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj pas vendimit nr.14921 / 3 të datës 8.08.2016 të Drejtorisë së Apelit të Taksave ('TAD') i cili pjesërisht shfuqizoi Njoftimin për Vlerësimin Tatimor nr.02 / 4 të datës 11.04.2016 në lidhje me detyrimet shtesë të Taksës për vitin 2013 të ngarkuara nga Zyra VIP / Pandehuri për shkak të shpenzimeve që nuk njiheshin si të zbritshme për shkak të dështimit të pretenduar të PMA për të paguar shumën përkatëse të WHT ose për të shteruar procedurën e aplikimit të DTT. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me Aktgjykimin e saj nr.584531005-07114-80-2016, të datës 12.12.2016, hodhi poshtë padinë e Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj (VIP Office) kundër TAD, ku PMA merr pjesë në këtë çështje gjyqësore në cilësinë e palës së tretë në proces. Gjykata e Shkallës së Parë Administrative të Tiranës vendosi që PMA ka shteruar procedurat përkatëse të DTT siç kërkohet me ligj. Zyra VIP ka parashtruar kërkesë për ankesë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Rasti pritet të gjykohet në vitin 2019. Shoqëria ka paguar shumën e plota që dalin nga ky rast gjatë viteve të mëparshme.

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**19. Detyrime të mundshme (vazhdim)**

*(b) Policat e Sigurimit*

Shoqëria zotëron polica sigurimi në lidhje me aktivet e saj, operacionet, punonjësit ose risqe të tjera të sigurueshme.

*(c) Çështje ligjore*

Në opinionin e drejtuesve të shoqërisë aktualisht nuk ka procedime ligjore, ose pretendime të tjera të papaguara, të cilat mund të kenë një efekt material mbi rezultatin operativ ose pozicionin financiar të shoqërisë dhe të cilat nuk janë përlogaritur ose paraqitur në këto pasqyra financiare.

**20. Angazhimet**

*Angazhimet e qerasë operative– Shoqëria si qeramarrëse*

Shoqëria ka marrë me qera, zyrat dhe magazinën sipas kontratave të qerasë operative. Afatet e qerave janë midis 1 dhe 5 vjet, dhe shumica e kontratave të qerave janë të rinovueshme në fund të periudhës së qerasë, me çmimin e tregut.

Pagesat minimale të agreguara të ardhshme të qerave, sipas kontratave të qerave operative të paanullueshme, janë si më poshtë

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Jo më shumë se 1 vit	17,038	38,607
Më vonë se 1 vit por jo më vonë se 5 vjet	35,667	56,452
<b>Totali</b>	<u>52,705</u>	<u>95,059</u>

**21. Transaksionet me palët e lidhura**

Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2017, shoqëria zotërohej plotësisht nga Philip Morris S.A. Switzerland, e cila zotërohet nga Philip Morris International Inc. Palët e lidhura, përfshijnë të gjitha shoqëritë anëtare të Philip Morris International Inc.

Transaksionet e mëposhtme u kryen me palë të lidhura:

<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>Kompania mëmë</u>	<u>Palë të lidhura</u>	<u>Totali</u>
Klientë dhe të tjera të arkëtueshme	-	-	-
Furnitorë dhe të tjera të pagueshme	-	433,891	433,891
<hr/>			
<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>Kompania mëmë</u>	<u>Palë të lidhura</u>	<u>Totali</u>
Blerje produktesh	-	3,095,967	3,095,967
Blerje shërbimesh	-	143,512	143,512
Të ardhura të tjera	-	-	-

**PHILIP MORRIS ALBANIA SHPK**  
**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

*(Të gjitha shumat janë në mijë LEK, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

**21. Transaksione me palë të lidhura (vazhdim)**

31 Dhjetor 2016	Kompania mëmë	Palë të lidhura	Totali
Kientë dhe të tjera te arkëtueshme	-	-	-
Furnitorë dhe të tjera të pagueshme	-	604,525	604,525

31 Dhjetor 2016	Kompania mëmë	Palë të lidhura	Totali
Blerje produktesh	-	2,943,049	2,943,049
Blerje shërbimesh	-	179,163	179,163
Të ardhura të tjera	-	-	-

***Kompensimi për menaxhimin kryesor***

Menaxhimi kryesor përbëhet nga drejtori i shoqërisë dhe punonjës të tjerë sipas marrëveshjes mbi shërbimet e personelit midis Shoqërisë dhe PM Services SA. Kompensim i paguar ose që duhet paguar për menaxhimin kryesor është paraqitur më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime për menaxhimin kryesor	61,409	106,577
<b>Totali</b>	<b>61,409</b>	<b>106,577</b>

**22. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas periudhës së raportimit që do të kërkonte ndryshime në informacionin e këtyre pasqyrave financiare.